

RAPORT

I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Mbi bashkimin me perthithje te shoqerise "Joti" shpk Fier, me shoqerine tregtare "Joti sha 2010" Fier, ku shoqeria tregtare "Joti" shpk Fier eshte perthithesja dhe shoqeria "Joti sha 2010" eshte shoqeria e perthithur.

ORTAKEVE TE SHOQERISE "JOTI" SHPK

AKSIONEREVE TE SHOQERISE "JOTI SHA 2010"

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar jam caktuar nga ortaket e shoqerise "Joti" shpk, Fier dhe aksioneret e shoqerise "Joti sha 2010", Fier: perkatesisht ne mbledhjet e asamblese se ortakeve date 08.01.2018 dhe asamblese se aksionere po date 08.01.2018 per kryerjen e aktit te ekspertimit per te vleresuar kushtet e projektmarveshjes se bashkimit, vecanerisht ne llogaritjen e raportit te ortakeve ne kapitalin themeltar ku si baze nisje per llogaritjen e kuotave sipas pikes nr.11 te projektmarveshjes do te meret kapitali neto i shoqerise ne date 31.12.2017 pas bashkimit (Aktivet – Detyrimet).

Baza ligjore: Ligji 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" neni 215 deri dhe 224.

Dokumentacioni i shoqerive: Akt themelimi, Statuti, Bilancet kontabel dhe pasqyrat financiare te ushtrimit 2017, inventaret per çdo post te bilancit.

Qellimi i shnderrimit: Manaxhim me i mire dhe rezultativ i aktivitetit ekonomik.

Te dhena mbi shoqerite qe marrin pjese ne bashkim

Shoqeria tregtare "Joti" shpk, Fier shoqeria perthithese eshte rregjistruar si person juridik ne date 24.07.1997, rregjistruar ne Njesine e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane me nipt J63423456C.

Adresa e shoqerise eshte: Lagja 1 Maj, Fier.

Ortake te kesaj shoqerie jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit te barabarta me 15.036.500 leke.

Kapitali i rregjistruar i shoqerise "Joti" shpk Fier eshte 60.146.000 leke i perbere nga 60.146 kuota me vlere nominale 1.000 leke secila.

Administrator i shoqerise "Joti" shpk eshte z. Ilir Joti.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: "Transport dhe Tregtim Karburantesh dhe Gazi, Ambiente Sherbimi (Lokal). Bar Bufe, Restorant, Hoteleri, Sherbime te ushqimit social, Lavazho Servis mjetesh dhe shitje pjese kembimi".

Shoqëria tregtare "Joti sha 2010", Fier, shoqëria përthithese është regjistruar si person juridik ne date 18.02.2011, regjistruar ne Njesine e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane me nipt L13818401D.

Adresa e shoqërisë është: Autostrada Fier-Lushnje, Krutje e Poshtme, Fier.

Aksionere te kesaj shoqërie jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njetepesepërqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njetepesepërqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njetepesepërqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njetepesepërqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,

Kapitali i regjistruar i shoqërisë "Joti sha 2010" Fier është 3.500.000 leke i perbere nga 100 aksione me vlere nominale 35.000 leke secila.

Administrator i shoqërisë "Joti sha 2010" sha është z. Eltjon Joti.

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është: *"Tregtim hidrokarburesh me shumice: Benzine, Gazoil, Bitum, Mazut, Vaj lubrifikant. Transport i karburanteve, lendeve te rrezikshme. Import-Eksport"*.

Sipas vendimit te asamblese te aksionereve te shoqërisë "Joti sha 2010" date 08.01.2018 si edhe asamblese se ortakeve te shoqërisë "Joti" shpk date 08.01.2018 është vendosur:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Joti sha 2010" nga shoqëria "Joti" shpk.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet "Joti" shpk Fier.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë z. Ilir Joti, administratori aktual i shoqërisë "Joti" shpk, Fier.
5. Eksperti kontabël zj. Aida Maloku te hartojë raportin e bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
6. Shoqëria "Joti sha 2010", Fier pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, ndaj reregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 "Për Regjistrin e Biznesit.
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël.

Administratoret e shoqërive kane hartuar dhe firmosuar projekt marrëveshjen per bashkimin me perthithje te shoqërisë "Joti sha 2010" nga shoqëria "Joti" shpk. Sipas projekt marrëveshjes shoqëritë kane rene dakort per menyren e realizimit te bashkimit i cili do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqëria tregtare "Joti" shpk, Fier do te jete shoqëria perthithese dhe shoqëria tregtare "Joti sha 2010", Fier do te jete shoqëria e perthithur. Pra do te behet kalimi i te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqërisë "Joti sha 2010" shoqërisë se perthithur tek shoqëria "Joti shpk" shoqëria perthithese ne kembim te kuotave te kesaj shoqërie, po keshtu, ne akt marrëveshje është caktuar edhe raporti i kembimit te aksioneve. Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e

bashkimit me përthithje zotërohen nga te njëjtet aksionere/ortake dhe me te njejtën përqindje ne pjesmarrje te cilet jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.

Duke e marrë në konsideratë këtë fakt, nuk do të ndryshojë përqindja e pjesmarrjes se ortakeve pas bashkimit nga përthithja e Shoqërisë “Joti sha 2010” nga shoqëria “Joti” shpk ne vlerën e përcaktuar në raportin e ekspertit kontabël. Kapitali i shoqërisë përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve) pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithjen e shoqërisë “Joti sha 2010” do të përbëhet nga kapitalet e secilës prej shoqërive në momentin e realizimit të këtij procesi vlerë e cila do të përcaktohet sipas raportit të ekspertit (ku si baze nisje per llogaritjet e kuotave te merren kapitalet neto Aktivët-Detyrimet). Pra përthithja do te shoqerohet me zmadhim kapitali ne perputhje me nenin 219.

Sipas mendimit tim raporti i kembimit te aksioneve, ruajtja e te njejtave përqindje ne pjesmarrje eshte i drejte dhe i arsyeshem. Si baze per llogaritjen e kapitalit te bashkimit jane marre kapitalet neto te te dy shoqerive e percaktuar si diference e aktiveve dhe detyrimeve.

Duke u nisur nga treguesit e bilanceve te mbylljes ne date 31.12.2017 te shoqerive “Joti”shpk, Fier dhe “Joti sha 2010” Fier para perthithjes (bashkimit) si edhe nga projekti i perthithjes (bashkimit) i miratuar nga organet vendimmarrese te te dy shoqerive qe marrin pjese ne procesin e perthithjes (bashkimit) shoqerise “Joti” shpk me shoqerine “Joti sha 2010” te dhenat permbledhese paraqiten:

Treguesit para perthithjes te shoqerise “Joti”shpk

A.	AKTIVET	viti 2017	B.	PASIVET DHE KAPITALI	viti 2017
I	Aktivët Afatshkurtra		I	Pasivët Afatshkurtra	
1	Mjetet Monetare	955.601	3	Huate dhe parapagimet	
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtra		a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	64.598.364
a)	Kliente per mallra produkte e sherbime	39.373.176	b)	Te pag. ndaj punonjesve e sig shoq	361.123
b)	TVSH	4.243.371	c)	Detyrime tatimore	36.400
c)	Tatim fitimi	862.528	d)	Hua te tjera	35.688.846
d)	Te tjera kerkesa debitore	4.466.544			
	Totali	48.945.619		Totali	100.684.733
4	Inventari			Pasive Totale Afatshkurtera	100.684.733
a)	Lendet e para		II	Pasivët Afatgjata	
b)	Inventari I imet	372.280	1	Huate afatgjata	
c)	Prodhim ne proces			Totali Detyrimeve Afatgjata	
d)	Produkte te gatshme			Totali Detyrimeve	100.684.733
e)	Mallra per rishitje	26.989.764			
f)	Parapagesat per furnizime				
	Totali I inventarit	27.362.044			

	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKUTRA	77.263.264			
2	Aktive afatgjata materiale				
a)	Toka	12.400.000			
b)	Ndertesa +sheshet hyrese/dalese	129.846.090	III	Kapitali	
c)	Makineri e Pajisje	14.634.382	3	Kapitali nenshkruar	60.146.000
d)	Aktive te tjera afatgjata materiale	17.418.083	7	Rezerva Ligjore	5.619.688
	Totali	174.298.555	8	Rezerva te Tjera	79.206.593
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		10	Fitime (humbja) e vitit financiar	5.904.805
	Totali Aktiveve Afatgjata	174.298.555		Totali Kapitalit	150.877.086
	Totali I Aktivit	251.561.819		Totali Pasivit	251.561.819

Treguesit para perthithjes te shoqerise "Joti sha 2010"

A.	AKTIVET	viti 2017	B.	PASIVET DHE KAPITALI	viti 2017
I	Aktivitet Afatshkurtra		I	Pasivitet Afatshkurtra	
1	Mjetet Monetare	1.227.170	3	Huate dhe parapagimet	
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtra		a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	6.000.864
a)	Kliente per mallra produkte e sherbime	45.474.295	b)	Te pagueshme ndaj punonjes. e sig shoq	39.408
d)	Tatim mbi vleren e shtuar	948.014	c)	Detyrime tatimore	11.700
e)	Tatim fitimi	683.690	d)	Hua te tjera	4.426.861
	Totali	47.105.999		Totali	10.478.833
4	Inventari			Pasive Totale Afatshkurtera	10.478.833
a)	Lendet e para		II	Pasivitet Afatgjata	
b)	Inventari I imet		1	Huate afatgjata	
c)	Prodhim ne proces			Totali Detyrimeve Afatgjata	
d)	Produkte te gatshme			Totali Detyrimeve	10.478.833
e)	Mallra per rishitje				
f)	Parapagesat per furnizime				
	Totali I inventarit				
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKUTRA	48.333.169			
2	Aktive afatgjata materiale				
a)	Toka				
b)	Ndertesa		III	Kapitali	
c)	Makineri e Pajisje		3	Kapitali aksionar	3.500.000
d)	Aktive te tjera afatgjata materiale	8.909.359	7	Rezerva Ligjore	2.131.217
	Totali	8.909.359	8	Rezerva te Tjera	39.993.117
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		10	Fitime (humbja) e vitit financiar	1.139.361
	Totali Aktiveve Afatgjata			Totali Kapitalit	46.763.695
	Totali I Aktivit	57.242.528		Totali Pasivit	57.242.528

Nga treguesit e mesiperm llogaritja e kuotave te kapitalit neto te shoqerise "Joti" shpk pas perthithjes (bashkimi) paraqitet:

Kapitali nenshkruar	197.640.000
Rezerva Ligjore	
Rezerva te Tjera	781
Fitime (humbja) e vitit financiar	
Totali Kapitalit	197.640.781

Kapitali bashkimit u formua nga:

	Kapitalet e veta Joti shpk	Kapitalet e veta Joti sha 2010	Kapitali Joti shpk pas bashkimit
Kapitali aksionar	60,146,000	3,500,000	197,640,000
Rezerva Ligjore	5,619,688	2,131,217	
Rezerva te Tjera	79,206,593	39,993,117	781
Fitime (humbja) e vitit financiar	5,904,805	1,139,361	
Totali Kapitalit	150,877,086	46,763,695	197,640,781

Ne llogarine rezerva te tjera eshte lene diferenca 781 leke per efekt te rrumbullakimit te pjeseve.

Kapitali nenshkruar i shoqerise "Joti" shpk pas bashkimit me shoqerine "Joti sha 2010" eshte 197.640.000 leke i perbere nga 4 kuota ku Ortaket dhe pjesmarrja e tyre ne kapital pas bashkimit eshte:


- z. Kostandin Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke,
- z. Eltjon Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke,
- z. Ilir Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke,
- zj. Pranvera Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke.

Kontributet e nenshkruara te kapitalit jane te paguara (kontribuet e e seciles shoqeri jane te perbera nga kapitali fillestar i paguar si edhe nga zmadhimet e tij me fitimet e akumuluar). Shoqëria "Joti" shpk do të jetë zotëuese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë "Joti sha 2010" në datën e bashkimit. Shoqëria "Joti" shpk në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga shoqëria "Joti sha 2010" në këtë datë.

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Aida Maloku

Fier, me 08.02.2018


EKSPERT. KONTABEL
I AUTORIZUAR
AIDA MALOKU

Shoqëria "Joti" shpk

Fier me 15.01.2018

Nipt J63423456C

RAPORT

Mbi bashkimin me perthithje te shoqërise "Joti" shpk Fier, me shoqërine tregtare "Joti sha 2010" sha Fier, ku shoqëria tregtare "Joti" shpk eshte perthithesja dhe shoqëria "Joti sha 2010" eshte shoqëria e perthithur.

Drejtuar per vendimarrje:

Ortakeve te shoqërise tregtare "Joti" shpk, Fier.

Me vendimin Nr.1, datë 08.01.2018 të asamblese se ortakeve te shoqërise "Joti" shpk, qe jane njekoheesisht edhe aksioneret e shoqërise "Joti sha 2010" u vendos:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Joti sha 2010" nga shoqëria "Joti" shpk.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet "Joti" shpk, me adrese Lagja 1 Maji Fier.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë z. Ilir Joti, administratori aktual i shoqërisë "Joti" shpk, Fier.
5. Eksperti kontabël zj. Aida Maloku te hartojë raportin per te vleresuar kushtet e projekt marrveshjes se bashkimit, vecanerisht ne llogaritjen e raportit te ortakeve ne kapitalin e nenshkruar te bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
6. Shoqëria "Joti sha 2010", Lushnje pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, ndaj crregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 "Për Regjistrin e Biznesit.
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas nenit 219 te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".

Administratoret e dy shoqërive qe marrin pjese ne kete proces kane hartuar projekt marrveshjen dhe kane përcaktuar afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

1. Shoqëritë që marrin pjesë në kete bashkim

Shoqëria tregtare "Joti" shpk, Fier eshte rregjistruar si person juridik ne date 24.07.1997, rregjistruar ne Njesine e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane me nipt J63423456C.

Adresa e shoqerise eshte: Lagja 1 Maj, Fier.

Ortake te kesaj shoqerie jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te kuotave te kapitalit te barabarta me 15.036.500 leke.

Kapitali i rregjistruar i shoqerise "Joti" shpk Fier eshte 60.146.000 leke i perbere nga 60.146 kuota me vlere nominale 1.000 leke secila.

Administrator i shoqerise "Joti" shpk eshte z. Ilir Joti.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: *"Transport dhe Tregtim Karburantesh dhe Gazi, Ambiente Sherbimi (Lokal). Bar Bufe, Restorant, Hoteleri, Sherbime te ushqimit social, Lavazho Servis mjetesh dhe shitje pjese kembimi"*.

Shoqeria tregtare "Joti sha 2010", Fier eshte rregjistruar si person juridik ne date 18.02.2011, rregjistruar ne Njesine e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane me nipt L13818401D.

Adresa e shoqerise eshte: Autostrada Fier-Fier, Krutje e Poshtme, Fier.

Aksionere te kesaj shoqerie jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njezetepesepersqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,

Kapitali themeltar i shoqerise "Joti" shpk Fier eshte 3.500.000 leke i perbere nga 100 aksione me vlere nominale 35.000 leke secila.

Administrator i shoqerise "Joti sha 2010" eshte z. Eltjon Joti.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: *"Tregtim hidrokarburesh me shumice: Benzine, Gazoil, Bitum, Mazut, Vaj lubrifikant. Transport i karburanteve, lendeve te rrezikshme. Import-Eksport"*.



2. Pranimi i paleve per kalimin e pasurive te seciles shoqeri ne kembim te kuotave

Të dyja shoqëritë kanë rene dakort qe bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare "Joti" shpk, Fier do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare "Joti sha 2010", Fier do te jete shoqeria e perthithur. Pra do te behet kalimi i te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise "Joti sha 2010" e cila eshte shoqeria e perthithur tek shoqeria "Joti shpk" e cila eshte shoqeria perthithese ne kembim te kuotave te kesaj shoqerie.

3. Raporti i këmbimit të aksioneve

Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e bashkimit me përthithje zotërohen nga te njëjtet aksionere/ortake dhe me te njejten perqindje ne pjesmarrje:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e seciles shoqeri.

Duke e marrë në konsideratë këtë fakt, nuk do të ndryshojë perqindja e pjesmarrjes se ortakeve pas bashkimit nga përthithja e Shoqërisë "Joti sha 2010" nga shoqëria "Joti" shpk.

Kapitali nenshkruar i shoqerise "Joti" shpk pas bashkimit me shoqerine "Joti sha 2010" do te jete 197.640.000 leke i perbere nga 4 kuota ku Ortaket dhe pjesmarrja e tyre ne kapital pas bashkimit do te jete:

- z. Kostandin Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke,
- z. Eltjon Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke,
- z. Ilir Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke,
- zj. Pranvera Joti zoterues i nje kuote, me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) ne kapitalin e nenshkruar, te barabarte me 49.410.000 leke.

Kontributet e nenshkruara te kapitalit jane te paguara (kontribuet e e seciles shoqeri jane te perbera nga kapitali fillestar i paguar si edhe nga zmadhimet e tij me fitimet e akumuluar).

4. Kushtet e ndarjes së aksioneve si dhe data për ndarjen e fitimit të Shoqërisë përthithëse

Aksionet në shoqërinë qe perthithet zotërohen nga te njëjtet ortake te shoqerise perthithese, duke e konsideruar këtë fakt, nuk ka kushte të ndarjes së aksioneve, si dhe përcaktimin e një date për ndarjen e fitimit.

5. Data e përcaktuar për trajtimin kontabël të veprimeve të kryera.

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej Shoqërisë "Joti sha 2010" nga data 01 janar 2018 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit

pranë QKB-së, datë në të cilën do të ndodhë çregjistrimi pa likuidim i Shoqërisë “Joti sha 2010”, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria Përthithëse “Joti” shpk, dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilin do të bëhet bashkimi është data 31/12/2017, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31/12/2017.

6. Të drejta dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion bashkimi me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

7. Përparësitë e organeve të administrimit

Anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë “Joti” shpk në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë Përthithëse.

Statuti i shoqërisë “Joti” shpk, mbas ndryshimeve që mund të bëhen do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë z. Ilir Joti, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

8. Pasojat që do të ketë bashkimi ndaj punëmarrësve

Punëmarrësit e Shoqërisë “Joti sha 2010” mbas datës së bashkimit me përthithje do të përfshihen si punëmarrës tek Shoqëria Përthithëse.

9. Modalitetet

Shoqëria “Joti” shpk do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë “Joti sha 2010” në datën e bashkimit.

Shoqëria “Joti” shpk në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga shoqëria “Joti sha 2010” në këtë datë.

10. Garancitë për kreditorët dhe mbrojtja e tyre

E rëndësishme në këtë procedurë bashkimi me përthithje të shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive që marrin pjesë në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (të cilat do të jenë pjesë në raportin e ekspertit kontabël), për faktin se:

Debitori fillestar humbet formën ligjore ose çregjistrohet (Shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen Shoqërisë përthithëse “Joti” shpk.

Në zbatim të ligjit Shoqëria përthithëse merr përsipër të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur, që ti drejtojnë të gjitha pretendimet e tyre ndaj Shoqërisë përthithëse “Joti” shpk.

11. Ekspertët

Me qëllim, vlerësimin e kushteve të kësaj projekt marrëveshje të bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse, në këtë procedurë bashkimi me përthithje, me vendimin Nr.1 datë 08/01/2018 të asambleve respektive është emëruar zj. Aida Maloku, me nr. ID 029270561, banuese në Tiranë, eksperte kontabël e regjistruar (Audituese ligjore) anëtare e IEKA, mbajtëse e licencës me nr. 55 datë 10.02.2000.

Eksperti ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim, nëpërmjet të cilit do të deklarojë dhe vlerësojë kapitalin e shoqërive.

Kapitali i shoqërisë përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve) pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithjen e shoqërisë “Joti sha 2010” (shoqëria kontribuese) do të përbëhet nga kapitalet e secilës prej shoqërive në momentin e realizimit të këtij procesi vlerë e cila do të përcaktohet sipas raportit të ekspertit (ku si baze nisje për llogaritjet e kuotave të merren kapitalet neto Aktiv-Detyrimet). Pra përthithja do të shoqërohet me zmadhim kapitali në përputhje me nenin 219.

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë proces bashkimi me përthithje, garantojnë sipas ligjit, se ekspertit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllimin e kryerjes së procedurave ligjore.

12. Premtime deri në mbyllje dhe pas mbylljes

Deri në datën e mbylljes, palët bien dakord:

- Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë projekt marrëveshje si dhe dokumenta të tjera në lidhje me to.
- Të njoftojnë Drejtoritë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruara si subjekt në lidhje me operacionin e bashkimit.
- Të ndërmarrin çdo veprim për depozitimin e të gjithë dokumentacionit pranë QKB-së brenda afateve ligjore.
- Kalimin e të punësuarëve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse pas procesit të mbylljes.

13. Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë përthithëse “Joti ” shpk

Shoqëria “Joti” shpk dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë projekt marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria “Joti” shpk nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

14. Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë së përthithur “Joti sha 2010”



Shoqëria “Joti sha 2010” dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë projekt marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria “Joti sha 2010” nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

15. Konfidencialiteti

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfituara si rezultat i realizimit të kësaj projekt marrëveshje, që ka të bëjë me negociatat si dhe me çdo dokument tjetër që referohet nga kjo projekt marrëveshje.

Palët mund të japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- Kërkohe me ligj ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore.
- Kërkohe nga ndonjë institucion qeveritar.
- Me miratimin paraprak dhe me shkrim të palës tjetër.

Autorizohet z. Aurel Preni, të ndjek të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e të gjitha akteve për realizimin e procedurës së bashkimit me përrthithje.

Administrator

Ilir Joti



RAPORT

Mbi bashkimin me perthithje te shoqërise "Joti sha 2010" sha, Fier me shoqërine tregtare "Joti" shpk, Fier , ku shoqëria tregtare "Joti" shpk Fier eshte perthithesja dhe shoqëria "Joti sha 2010" Fier eshte shoqëria e perthithur.

Drejtuar per vendimarrje:

Aksionereve te shoqërise tregtare "Joti sha 2010" sha, Fier.

Me vendimin Nr.1, datë 08.01.2018 të asamblese se ortakeve te shoqërise "Joti" shpk, qe jane njekohesisht edhe aksioneret e shoqërise "Joti sha 2010" u vendos:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Joti sha 2010" nga shoqëria "Joti" shpk.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet "Joti" shpk, me adrese Lagja 1 Maji Fier.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë z. Ilir Joti, administratori aktual i shoqërisë "Joti" shpk, Fier.
5. Eksperti kontabël zj. Aida Maloku te hartojë raportin per te vleresuar kushtet e projekt marrveshjes se bashkimit, vecanerisht ne llogaritjen e raportit te ortakeve ne kapitalin e nenshkruar te bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar.
6. Shoqëria "Joti sha 2010", Lushnje pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, ndaj rregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 "Për Regjistrin e Biznesit.
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas nenit 219 te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".

Administratoret e dy shoqërive qe marrin pjese ne kete proces kane hartuar projekt marrveshjen dhe kane përcaktuar afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

1. Shoqëritë që marrin pjesë në kete bashkim

Shoqëria tregtare "Joti sha 2010", Fier eshte rregjistruar si person juridik ne date 18.02.2011, rregjistruar ne Njesine e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane me nipt L13818401D.

Adresa e shoqerise eshte: Autostrada Fier-Fier, Krutje e Poshtme, Fier.

Aksionere te kesaj shoqerie jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te aksioneve te kapitalit, te barabarta me 875.000 leke,

Kapitali themeltar i shoqerise "Joti" shpk Fier eshte 3.500.000 leke i perbere nga 100 aksione me vlere nominale 35.000 leke secila.

Administrator i shoqerise "Joti sha 2010" eshte z. Eltjon Joti.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: *"Tregtim hidrokarburesh me shumice: Benzine, Gazoil, Bitum, Mazut, Vaj lubrifikant. Transport i karburanteve, lendeve te rrezikshme. Import-Eksport"*.

Shoqeria tregtare "Joti" shpk, Fier eshte rregjistruar si person juridik ne date 24.07.1997, rregjistruar ne Njesine e Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane me nipt J63423456C.

Adresa e shoqerise eshte: Lagja 1 Maj, Fier.


Ortake te kesaj shoqerie jane:

- z. Kostandin Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- z. Eltjon Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- z. Ilir Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit, te barabarta me 15.036.500 leke,
- zj. Pranvera Joti me pjesmarje 25% (njetepeseperqind) te kuotave te kapitalit te barabarta me 15.036.500 leke.

Kapitali themeltar i shoqerise "Joti" shpk Fier eshte 60.146.000 leke i perbere nga 60.146 kuota me vlere nominale 1.000 leke secila.

Administrator i shoqerise "Joti" shpk eshte z. Ilir Joti.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: *"Transport dhe Tregtim Karburantesh dhe Gazi, Ambiente Sherbimi (Lokal). Bar Bufe, Restorant, Hoteleri, Sherbime te ushqimit social, Lavazho Servis mjetesh dhe shitje pjese kembimi"*.



2. Pranimi i paleve per kalimin e pasurive te seciles shoqeri ne kembim te kuotave

Të dyja shoqëritë kane rene dakort qe bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare “Joti” shpk, Fier do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare “Joti sha 2010”, Fier do te jete shoqeria e perthithur. Pra do te behet kalimi i te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise “Joti sha 2010” e cila eshte shoqeria e perthithur tek shoqeria “Joti shpk” e cila eshte shoqeria perthithese ne kembim te kuotave te kesaj shoqerie.

3. Raporti i këmbimit të aksioneve

